



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Zhvillimit Rajonal
Ministarstvo za Regionalni Razvoj
Ministry of Regional Development

Raporti i zbatimit të
Programit për Zhvillim Rajonal
për vitin 2024

Shkurt, 2025

Tabela e përmbajtjes

HYRJE.....	4
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....	5
Investimet e MZHR në Programin për Zhvillim Rajonal 2024	6
Shpërndarja e investimeve sipas rajoneve zhvillimore	6
Projektet e realizuara sipas rajoneve zhvillimore.....	9
Projektet e parealizuara.....	11
Lista e projekteve të parealizuara.....	11
Arsyet e mosrealizimit të projekteve.....	13
Projektet dyvjeçare: Përparimi në 2024 dhe bartja për 2025.....	13
Projektet që kanë nisur zbatimin në vitin 2024.....	14
Projektet që barten për realizim në vitin 2025	15
Përfundimi	18
ANEKS 1 Projektet dy vjeçare sipas PZHR 2023.....	19
ANEKS 2 Rajoni zhvillimor: Qendër.....	22
ANEKS 3 Rajoni zhvillimor: Veri	25
ANEKS 4 Rajoni zhvillimor: Perëndim.....	27
ANEKS 5 Rajoni zhvillimor: Jug.....	31
ANEKS 6 Rajoni zhvillimor: Juglindje	32
ANEKS 7 Rajoni zhvillimor: Lindje.....	35
ANEKS 8 Rajoni zhvillimor: Jugperëndim	38

Shkurtesat

MZHR	Ministria e Zhvillimit Rajonal
DPKZHR	Departamenti për Planifikim dhe Koordinim të Zhvillimit Rajonal
PZHR	Programi për Zhvillim Rajonal
DZHMP	Divizioni për Zhvillim dhe Menaxhim të Projekteve të Zhvillimit Rajonal
OSHP	Organi Shqyrtues i Prokurimit
MMPHI	Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës

Lista e tabelave

Tabela 1: Projekt propozimet e përzgjedhura të ndara sipas rajoneve zhvillimore dhe komunave përfituese	7
Tabela 2: Projektet e realizuara gjatë vitit fiskal 2024.....	9
Tabela 3: Projektet e përealizuara gjatë vitit fiskal 2024.....	11
Tabela 4: Analiza e faktorëve pengues në realizimin e projekteve	13
Tabela 5: Projektet që kanë nisur zbatimin në vitin 2024	14
Tabela 6: Projektet që barten për realizim në vitin 2025.....	17
Tabela 7: Ndërtimi i Stacionit të autobusëve – Komuna e Podujevës	19
Tabela 8: Rehabilitimi i infrastrukturës në fshatin Janjevë – Komuna e Lipjanit	20
Tabela 9: Kult Qendra – Komuna e Gjiçanit.....	21
Tabela 10: Ndërtimi i tregut të gjelbër – Komuna e Podujevës	22
Tabela 11: Rregullimi i parkut, shtigjeve për këmbësor dhe biçiklistë – Komuna e Drenasit.....	23
Tabela 12: Ndërtimi i parkut rekreativ në Sllatinë të Vogël - Komuna e Fushë Kosovës.....	24
Tabela 13: Udhë e Gurit - Komuna e Vushtrisë.....	25
Tabela 14: Ndërtimi i çerdhës për fëmijë - Komuna e Skenderajt.....	26
Tabela 15: Asfaltimi i rrugës Llugagji - Jabllanicë e Gjakovës - Komuna e Pejës.....	27
Tabela 16: Zgjerimi i infrastrukturës në zonën ekonomike në Istog - Komuna e Istogut.....	28
Tabela 17: Zhvillimi i turizmit në komunën e Deçanit - Produktet turistike në fshatin Alpin Bjeshkatarë - Komuna e Deçanit	29
Tabela 18: Rregullimi i trotuarit dhe shtegut të biçikletave me infrastrukturë përcjellëse nga qyteti i Klinës deri te udhëkryqi Pejë-Prishtinë - Komuna e Klinës.....	30
Tabela 19: Ndërtimi i shtigjeve të ecjes dhe këndi i lojërave për fëmijë - Komuna e Dragash.....	31
Tabela 20: Krijimi i infrastrukturës rekreative-sportive në zonën turistike Neredime-Jezerc - Komuna e Ferizajt.....	32
Tabela 21: Rregullimi i tregut të hapur në qytetin e Shtimes - Komuna e Shtimes	33
Tabela 22: Asfaltimi i rrugës “Eksodi 99” - Komuna e Hanit të Elezit.....	34
Tabela 23: Renovimi i objektit për inkubator biznesi - Komuna e Vitisë	35
Tabela 24: Parku i Avanturave Drenovc - Komuna e Ranillugut	36
Tabela 25: Rregullimi i shtratit të lumit Morava e Vjetër në Kllokot - Komuna e Kllokotit.....	37
Tabela 26: Renovimi i objektit të N.P.L. Stacioni i autobusëve - Komuna e Gjakovës.....	38
Tabela 27: Ndërtimi i Ballkonit Panoramik mbi qytetin e Rahovecit - Komuna e Rahovecit.....	39

Lista e figurave

Figura 1: Pjesëmarrja e rajoneve zhvillimore në mbështetjen financiare të PZHR-së.....	8
Figura 2: Shpërndarja e projekteve sipas nivelit të realizimit në PZHR	12
Figura 3: Shpërndarja e mjeteve të projekteve të planifikuara për realizim në vitin 2024 dhe që janë bartur për realizim në vitin 2025	16

HYRJE

Ministria e Zhvillimit Rajonal, përmes Programit për Zhvillim Rajonal 2024 (PZHR 2024), vazhdon të mbështesë iniciativat e qeverisë dhe institucioneve të ndryshme për zhvillimin e qëndrueshëm të rajoneve, me fokus të veçantë te ato që kanë nevojë për përmirësime në infrastrukturë, ekonomi dhe mundësi punësimi. PZHR 2024 synon të kontribuojë në balancimin e pabarazive ndërmjet rajoneve dhe të nxisë zhvillimin ekonomik të tyre.

Kosova, me shtatë rajonet e saj zhvillimore, ka karakteristika të dallueshme, por gjithashtu përballet me pabarazi të theksuara dhe nivele të ndryshme të zhvillimit socio-ekonomik. Për të përballuar këto sfida dhe për të nxitur zhvillimin e qëndrueshëm, PZHR 2024 është projektuar për të mbështetur një zhvillim të balancuar, duke shfrytëzuar potencialet specifike të secilit rajon dhe duke ruajtur karakteristikat natyrore dhe kulturore të tyre.

Ky program është pjesë e përpjekjeve të përgjithshme për përmirësimin e mirëqenies dhe standardeve të jetesës, si në qytete, ashtu edhe në zonat rurale, duke kontribuar kështu në një shoqëri më gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme. Objektivat e PZHR 2024 mbështeten në Strategjinë për Zhvillim Rajonal të Kosovës dhe dokumentet strategjike kombëtare.

Për vitin 2024, MZHR ka planifikuar një buxhet prej 4 milionë euro për realizimin e këtij programi.

Synimet specifike të mbështetjes financiare për vitin 2024 janë:

- ✓ **Zhvillimi i infrastrukturës:** Investime në rrugë, ujësjellës, energji dhe teknologji të tjera që kontribuojnë në rritjen e efikasitetit dhe lidhshmërisë rajonale.
- ✓ **Zhvillimi i qëndrueshëm dhe mbrojtja e mjedisit:** Nxitja e projekteve që kontribuojnë në zhvillimin e qëndrueshëm dhe ruajtjen e mjedisit natyror dhe kulturor.

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Programi për Zhvillim Rajonal 2024 ka si objektiv kryesor mbështetjen për investimet kapitale që kontribuojnë në zhvillimin socio-ekonomik të balancuar të rajoneve të Kosovës. Ky program ka disa synime të rëndësishme:

- *Promovimi i projekteve të integruara dhe gjithëpërfshirëse*, që janë në përputhje me objektivat e Strategjisë për Zhvillim Rajonal dhe strategjitë lokale përkatëse.
- *Fuqizimi i potencialeve ekonomike, turistike dhe mjedisore* nëpër komunat dhe rajonet e Kosovës, përmes zbatimit të projekteve që integrojnë sektorë të ndryshëm, si turizmi, ekonomia, kultura, shoqëria dhe mjedisi.

Ky program synon gjithashtu të përmirësojë infrastrukturën dhe shërbimet publike në nivel lokal, duke krijuar mundësi për rritje ekonomike dhe përmirësimin e kushteve të jetesës për qytetarët e Kosovës. Në vitin 2024, PZHR fokusohet në mbështetje të:

- *Projekteve që përmirësojnë infrastrukturën kapitale* në komunat e Kosovës.
- *Projekteve që kontribuojnë në zhvillimin e qëndrueshëm dhe krijimin e mundësive të reja ekonomike* në rajonet përkatëse.
- *Aplikimeve nga komunat për projekte që adresojnë nevojat specifike të komunitetit*, duke synuar ndikim të drejtpërdrejtë në përmirësimin e kushteve të jetesës.

Gjatë fazës së vlerësimit, u përzgjedhën 27 projekt propozime nga 27 komuna të Kosovës, duke përfshirë të gjitha rajonet zhvillimore. Një aspekt i rëndësishëm është se **52% e projekteve të përzgjedhura janë dyvjeçare**, duke siguruar kështu një angazhim afatgjatë për zhvillimin rajonal.

Vlera e Marrëveshjeve të Mirëkuptimit, të nënshkruara mes Ministrit të MZHR dhe kryetarëve të komunave, është mbi **7.46 milionë euro**, ku MZHR do të investojë **66% të vlerës së përgjithshme**.

Raporti i zbatimit të Programit për Zhvillim Rajonal për vitin 2024 është një raport i detajuar, bazuar në të dhëna të mbledhura nga DZHMP, kompania mbikëqyrëse për monitorimin e realizimit të projekteve, si dhe të dhënat financiare nga DBF. Të gjitha këto të dhëna janë analizuar përmes metodës së intervistës dhe metodës së analizës për të vlerësuar përparimin dhe ndikimin e projekteve në nivel lokal.

Investimet e MZHR në Programin për Zhvillim Rajonal 2024

Ministria e Zhvillimit Rajonal (MZHR), në kuadër të Programit për Zhvillim Rajonal 2024, ka përzgjedhur gjithsej 27 projekt propozime për të bashkëpunuar me komunat e ndryshme të Kosovës. MZHR ka nënshkruar 27 Marrëveshje Mirëkuptimi me kryetarët e komunave për realizimin e këtyre projekteve. Megjithatë, një marrëveshje është anuluar për shkak të ndërprerjes së punimeve nga zyrtarët përgjegjës të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), për shkak të mungesës së pëlqimit nga kjo ministri. Projekti i anuluar kishte për qëllim *ndërtimin e një objekti kullë për vizitorët tek bashkimi i dy lumenjëve* në Kaçanik, me një vlerë totale prej 75,000 euro (60,000 euro të financuara nga MZHR dhe 15,000 euro nga komuna).

Shpërndarja e investimeve sipas rajoneve zhvillimore

Projektet e financuara nga PZHR 2024 janë shpërndarë në shtatë rajone zhvillimore: Qendër, Veri, Perëndim, Jug, Juglindje, Lindje dhe Jugperëndim. Nga 27 projektet e përfituese, 14 prej tyre janë dyvjeçare, duke siguruar një angazhim afatgjatë për zhvillimin rajonal.

Renditja e rajoneve zhvillimore sipas mjeteve të ndara është si më poshtë:

- **Rajoni zhvillimor Jug** ka marrë më shumë mjete, me 570,000 euro, për projekte si *ndërtimi i një objekti administrativ për zejtarët në Prizren dhe ndërtimi i Shtëpisë së Kulturës në Mamushë.*
- **Rajoni zhvillimor Qendër** ka marrë 510,000 euro, për projekte si *sanimi i Pallatit të Rinisë në Prishtinë dhe rregullimi i parkut dhe shtigjeve për këmbësorë në Drenas.*
- **Rajoni zhvillimor Lindje** ka marrë 498,962 euro, për projekte si *rregullimi i shtratit të lumit Morava e Vjetër në Kllokot dhe renovimi i inkubatorit të bizneseve në Viti.*
- **Rajoni zhvillimor Veri** ka marrë 480,000 euro, për projekte si *ndërtimi i çerdhes në Skenderaj dhe renovimi i Qendrës Multifunkionale në Mitrovicë.*
- **Rajoni zhvillimor Perëndim** ka marrë 470,000 euro, për projekte si *zhvillimi i turizmit në Deçan dhe rregullimi i trotuarit dhe shtegut të biçikletave në Klinë.*
- **Rajoni zhvillimor Juglindje** ka marrë 360,000 euro, për projekte si *tregu i hapur në Shtime dhe asfaltimi i rrugës “Eksodi 99” në Hani të Elezit.*
- **Rajoni zhvillimor Jugperëndim** ka marrë më pak, me 250,000 euro, për projekte si *ndërtimi i stacionit të autobusëve në Gjakovë dhe ndërtimi i ballkonit panoramik në Rahovec.*

Tabela 1, më poshtë, paraqet projekt propozimet e përzgjedhura, sipas rajonit zhvillimor dhe komunës përfituese përfshirë vlerën e financuar nga MZHR dhe nga komunat.

Tabela 1: Projekt propozimet e përzgjedhura të ndara sipas rajoneve zhvillimore dhe komunave përfituese


Rajoni zhvillimor / Komuna	Emri i projektit	$\sum e$ financuar nga MZHR	$\sum e$ financuar nga komuna	TOTAL	% e financ. nga MZHR	% e financ. nga komuna
Rajoni Qendër		510,000.00	300,261.25	810,261.25	62.94	37.06
Prishtinë	Sanimi i Pallatit të Rinisë	120,000.00	80,000.00	200,000.00	60.00	40.00
Podujevë	Ndërtimi i tregut të gjelbërt	200,000.00	100,000.00	300,000.00	66.67	33.33
Drenas	Parku dhe shtigjet për këmbësorë	120,000.00	97,869.25	217,869.25	55.08	44.92
Fushë Kosovë	Parku rekreativ në Sllatinë	70,000.00	22,392.00	92,392.00	75.76	24.24
Rajoni Veri		480,000.00	308,072.12	788,072.12	60.91	39.09
Mitrovicë	Renovi. i Qendrës Multifunksionale	150,000.00	50,000.00	200,000.00	75.00	25.00
Vushtrri	Udha e Gurit	120,000.00	80,000.00	200,000.00	60.00	40.00
Skenderaj	Ndërtimi i çerdhes	210,000.00	178,072.12	388,072.12	54.11	45.89
Rajoni Perëndim		470,000.00	212,114.88	682,114.88	68.90	31.10
Pejë	Asfaltimi i rrugës Llugagji-Jabllanicë	120,000.00	26,549.88	146,549.88	81.88	18.12
Istog	Zona ekonomike në Istog	70,000.00	30,565.00	100,565.00	69.61	30.39
Deçan	Turizmi në Deçan	140,000.00	70,000.00	210,000.00	66.67	33.33
Klinë	Trotuari dhe shtigjet Klinë	140,000.00	85,000.00	225,000.00	62.22	37.78
Rajoni Jug		570,000.00	189,750.00	759,750.00	75.02	24.98
Prizren	Objekti admi. për nevojat e zejtarë.	160,000.00	20,000.00	180,000.00	88.89	11.11
Suharekë	Ura dhe lumi Tophulla	130,000.00	50,000.00	180,000.00	72.22	27.78
Dragash	Shtigjet dhe këndi i lojërave	55,000.00	19,750.00	74,750.00	73.58	26.42
Mamushë	Shtëpia e kulturës	225,000.00	100,000.00	325,000.00	69.23	30.77
Rajoni Juglindje		360,000.00	120,604.70	480,604.70	74.91	25.09
Ferizaj	Zona turistike Ferizaj	80,000.00	37,072.80	117,072.80	68.33	31.67
Shtime	Tregu i hapur Shtime	140,000.00	20,000.00	160,000.00	87.50	12.50
Kaçanik	Objekti kullë tek bashkimi i dy lumenjëve	60,000.00	15,000.00	75,000.00	80.00	20.00
Hani i Elezit	Asfaltimi i rrugës Eksodi 99	80,000.00	48,531.90	128,531.90	62.24	37.76

Rajoni Lindje		498,962.00	212,280.60	711,242.60	70.15	29.85
Viti	Inkubator biznesi	98,962.00	92,755.00	191,717.00	51.62	48.38
Kamenicë	Parku i Aventurave	50,000.00	30,000.00	80,000.00	62.50	37.50
Ranillugë	Parku i Aventurave	50,000.00	12,525.60	62,525.60	79.97	20.03
Partesh	Shtrati i lumit në fshatin Budrig	80,000.00	20,000.00	100,000.00	80.00	20.00
Novobërdë	Rrugës Dragancë e re dhe e vjetër	70,000.00	7,000.00	77,000.00	90.91	9.09
Kllokot	Shtrati i lumit Morava	150,000.00	50,000.00	200,000.00	75.00	25.00
Rajoni Jugperëndim		250,000.00	86,174.66	336,174.66	74.37	25.63
Gjakovë	Stacioni i autobusëve	120,000.00	36,174.66	156,174.66	76.84	23.16
Rahovec	Ballkoni panoramik	130,000.00	50,000.00	180,000.00	72.22	27.78
Totali		3,138,962.00	1,429,258.21	4,568,220.21	68.71	31.29

Burimi: DPKZHR - MZHR

Shpërndarja e investimeve tregon një qasje të balancuar në financimin e projekteve, duke marrë parasysh nevojat dhe prioritetet e secilit rajon zhvillimor. MZHR ka marrë angazhime për projekte në vlerë prej 3.14 milionë euro, ndërsa kontributi i komunave ka arritur në 1.43 milionë euro, duke e çuar investimin total në 4.57 milionë euro për vitin 2024. Këto mjete janë të dedikuara për përmirësimin e infrastrukturës lokale dhe zhvillimin socio-ekonomik të rajoneve zhvillimore.

Figura 1: Pjesëmarrja e rajoneve zhvillimore në mbështetjen financiare të PZHR-së



Burimi: DPKZHR - MZHR

Grafiku mësipër ilustron shpërndarjen e investimeve të Programit për Zhvillim Rajonal 2024, duke treguar përqindjet e financimit për secilin rajon zhvillimor. Siç tregohet, *rajoni zhvillimor Jug* ka marrë pjesën më të madhe të mjeteve financiare, pasuar nga *rajoni zhvillimor Qendër*, duke pasqyruar nevojat e zhvillimit të këtyre rajoneve në fushat e infrastrukturës dhe projekteve të tjera zhvillimore.

Projektet e realizuara sipas rajoneve zhvillimore

Gjatë vitin 2024, Ministria e Zhvillimit Rajonal, ka vazhduar implementimin e tre projekteve të përfituara në vitin 2023, sipas Marrëveshjeve të Mirëkuptimit të nënshkruara me komunat Podujevë, Lipjan dhe Gjilan, të cilat ishin pjesë e projekteve dy vjeçare në PZHR 2023.

Gjithashtu, gjatë vitit 2024, nga 27 projekte të miratuara, 17 janë përfunduar plotësisht, duke përmbyshur afatet dhe kërkesat. Një projekt ka përfunduar pjesërisht për shkak të kushteve atmosferike dhe vështirësive në terren. Kjo tregon se 63% e projekteve janë realizuar me sukses, ndërsa duke përfshirë projektin pjesërisht të realizuar, shkalla totale e realizimit arrin në 67%. Ky rezultat pasqyron angazhimin e MZHR-së dhe komunave për zhvillimin e rajoneve të Kosovës.

Si rezultat i këtyre projekteve, investimet kanë përmirësuar infrastrukturën lokale dhe kanë kontribuar në zhvillimin ekonomik, duke mundësuar ndërtimin e rrugëve, hapësirave rekreative dhe modernizimin e tregjeve. Po ashtu, janë restauruar objekte kulturore dhe sociale, duke rritur cilësinë e jetesës.

Në tabelën e mëposhtme, paraqiten detajet financiare dhe progresi i secilit projekt gjatë vitit 2024, duke treguar shpërndarjen e mjeteve dhe suksesin e përfundimit të punimeve.

Tabela 2: Projektet e realizuara gjatë vitit fiskal 2024

Rajoni zhvillimor / Komuna	Emri i projektit	$\sum$ e aprovuar nga MZHR	$\sum$ e realizuar sipas situacioneve	Diferenca
Projektet dy vjeçare sipas PZHR 2023		560,000.00	671,104.67	-111,104.67
Podujevë	Ndërtimi i Stacionit të autobusëve	300,000.00	300,000.00	0.00
Lipjan	Rehabilitimi i infrastrukturës në fshatinë Janjevë	130,000.00	130,000.00	0.00
Gjilan	Kult Qendra	130,000.00	241,104.67	-111,104.67 ¹

¹ Diferenca prej 111,104.67 euro është obligim i bartur nga viti 2023.

Rajoni Qendër		390,000.00	390,000.00	0.00
Podujevë	Ndërtimi i tregut të gjelbërt	200,000.00	200,000.00	0.00
Drenas	Parku dhe shtigjet për këmbësorë	120,000.00	120,000.00	0.00
Fushë Kosovë	Parku rekreativ në Sllatinë	70,000.00	70,000.00	0.00
Rajoni Veri		330,000.00	329,981.65	18.35
Vushtrri	Udha e Gurit	120,000.00	120,000.00	0.00
Skenderaj	Ndërtimi i çerdhes	210,000.00	209,981.65	18.35
Rajoni Perëndim		470,000.00	383,350.00	86,650.00
Pejë	Asfaltimi i rrugës Llugagji-Jabllanicë e Gjakovës	120,000.00	120,000.00	0.00
Istog	Zona ekonomike në Istog	70,000.00	70,000.00	0.00
Deçan	Turizmi në Deçan	140,000.00	53,350.00	86,650.00
Klinë	Trotuari dhe shtigjet Klinë	140,000.00	140,000.00	0.00
Rajoni Jug		55,000.00	55,000.00	0.00
Dragash	Shtigjet dhe këndi i lojërave	55,000.00	55,000.00	0.00
Rajoni Juglindje		360,000.00	308,778.11	51,221.89
Ferizaj	Zona turistike Ferizaj	80,000.00	80,000.00	0.00
Shtime	Tregu i hapur Shtime	140,000.00	140,000.00	0.00
Hani i Elezit	Asfaltimi i rrugës Eksodi 99	80,000.00	80,000.00	0.00
Kaçanik	Objekti kullë tek bashkimi i dy lumenjëve ²	60,000.00	8,778.11	51,221.89
Rajoni Lindje		298,962.00	295,964.20	2,997.80
Viti	Inkubator biznesi	98,962.00	95,964.20	2,997.80 ³
Ranillugë	Parku i Aventurave	50,000.00	50,000.00	0.00
Kllokot	Shtrati i lumit Morava	150,000.00	150,000.00	0.00
Rajoni Jugperëndim		250,000.00	223,850.80	26,149.20
Gjakovë	Stacioni i autobusëve	120,000.00	93,850.80	26,149.20 ³
Rahovec	Ballkoni panoramik	130,000.00	130,000.00	0.00
Totali		2,713,962.00	2,658,029.43	55,932.57

Burimi: DPKZHR – MZHR

² Anulim i Marrëveshjes së Mirkuptimit.³ Kontrata mes OE dhe komunës ka vlerë më të vogël sesa vlera parallogaritare e cila është nënshkruar.

Siç tregohet në tabelë, shumica e projekteve janë realizuar sipas planit të paraparë. Megjithatë, një komunë ka hasur në sfida që ka shkaktuar vonesa në përmbylljen e punimeve sipas planifikimit të vitit 2024. Pavarësisht këtyre vështirësive, investimet e MZHR-së kontribuan në përmirësimin e infrastrukturës dhe zhvillimin ekonomik lokal.

Projektet e parealizuara

Përkundër përpjekjeve për zbatim të suksesshëm të të gjitha investimeve të planifikuara, disa nuk kanë arritur të përfundojnë brenda afatit të përcaktuar, ndërsa disa të tjera nuk kanë nisur fare.

Lista e projekteve të parealizuara

Tabela 3 paraqet projektet e parealizuara gjatë vitit 2024, duke shfaqur financimin nga MZHR dhe kontributin e komunave. Këto projekte, që mbulojnë zhvillim infrastrukturor dhe lokal, nuk u realizuan brenda afateve dhe do të realizohen në vitin vijues.

Tabela 3: Projektet e parealizuara gjatë vitit fiskal 2024

Rajoni zhvillimor / Komuna	Emri i projektit	Σ e financuar nga MZHR	Σ e financuar nga komuna	TOTAL	% e financuar nga MZHR	% e financuar nga komuna
Rajoni Qendër		120,000.00	80,000.00	200,000.00	60.00	40.00
Prishtinë	Sanimi i Pallatit të Rinisë	120,000.00	80,000.00	200,000.00	60.00	40.00
Rajoni Veri		150,000.00	50,000.00	200,000.00	75.00	25.00
Mitrovicë	Renovimi i Qendrës Multifunksionale	150,000.00	50,000.00	200,000.00	75.00	25.00
Rajoni Jug		515,000.00	170,000.00	685,000.00	75.18	24.82
Prizren	Objekti admini. për nevojat e zejtarëve	160,000.00	20,000.00	180,000.00	88.89	11.11
Suharekë	Ura dhe lumi Tophulla	130,000.00	50,000.00	180,000.00	72.22	27.78
Mamushë	Shtëpia e kulturës	225,000.00	100,000.00	325,000.00	69.23	30.77
Rajoni Lindje		200,000.00	57,000.00	257,000.00	77.82	22.18
Kamenicë	Parku i Aventurave	50,000.00	30,000.00	80,000.00	62.50	37.50
Partesh	Shtrati i lumit në fshatin Budrig	80,000.00	20,000.00	100,000.00	80.00	20.00
Novobërdë	Rrugës Dragancë e re dhe e vjetër	70,000.00	7,000.00	77,000.00	90.91	9.09
Totali		985,000.00	357,000.00	1,342,000.00	73.40	26.60


Burimi: DPKZHR – MZHR

Nga analiza e të dhënave, vërehet se projektet e parealizuara janë të shpërndara në disa rajone zhvillimore. *Rajoni zhvillimor Jug* ka vlerën më të lartë të projekteve të parealizuara (685,000 euro), ndërsa *rajoni zhvillimor Lindje* ka vlerën më të ulët (257,000 euro).

Projektet e parealizuara përfshijnë ndërhyrje të ndryshme, si *sanimi i Pallatit të Rinisë* në Prishtinë, *renovimi i Qendrës Multifunktionale* në Mitrovicë, *ndërtimi i objektit administrativ për zejtar* në Prizren dhe *rehabilitimi i shtratit të lumit* në Partesh. MZHR ka siguruar që mbështetja e saj financiare të arrijë mesatarisht deri në 72% të vlerës totale të projektit, megjithatë ka raste kur një projekt i caktuar, si ai në Novobërdë, ka përfituar një financim më të lartë nga MZHR (91%), ndërsa projekti në Viti ka marrë financim më të ulët (52%).

Këto të dhëna përputhen me analizën e përgjithshme të realizimit të projekteve në kuadër të PZHR 2024, e cila paraqitet në grafikun vijues.

Figura 2: Shpërndarja e projekteve sipas nivelit të realizimit në PZHR



Burimi: DPKZHR – MZHR

Siç shihet, shumica e projekteve janë realizuar, por një përqindje e konsiderueshme mbetet e parealizuara, duke reflektuar sfidat e hasura gjatë implementimit. Këto të dhëna nënvizojnë rëndësinë e identifikimit dhe adresimit të sfidave që kanë ndikuar në vonesat dhe mosrealizimin e disa projekteve, duke siguruar një qasje më efektive për implementimin në të ardhmen.

Në vazhdim analizohen faktorët kryesorë që kanë ndikuar në vonesat dhe mosrealizimin e disa projekteve, duke ofruar një pasqyrë më të detajuar mbi sfidat e hasura.

Arsyet e mosrealizimit të projekteve

Dështimi në realizimin e këtyre projekteve mund të jetë rezultat i disa faktorëve, përfshirë problemet me procedurat e prokurimit, vonesat administrative, si dhe faktorë të jashtëm që kanë ndikuar në zbatimin e tyre.

Tabela 4: Analiza e faktorëve pengues në realizimin e projekteve

FAKTORI	PËRSHKRIMI	SHEMBULL
PROBLEMET ME PROCEDURAT E PROKURIMIT	Vonesa në proceset e tenderimit dhe ankesat në OSHP në shumicën e rasteve kanë çuar në mosrealizimin e projekteve brenda afateve të planifikuara.	Në projektin <i>ndërtimi i objektit administrativ për zejtar në Prizren</i> , procesi i prokurimit u anulua për shkak të një ankese, duke shtyrë fillimin e punimeve për një vit.
VONESA ADMINISTRATIVE DHE MUNGESA E KAPACITETEVE	Disa projekte kanë hasur në vështirësi për shkak të kapaciteteve të kufizuara administrative në nivel lokal dhe të ndërlikimeve burokratike.	Për projektin <i>ndërtimi i Shtëpisë së Kulturës në Mamushë</i> , vonesa në miratimin e lejeve të nevojshme ka bërë që ai të mos zbatohet brenda vitit fiskal.
FAKTORË TË JASHTËM	Ndikimi i kushteve atmosferike, probleme teknike apo ndryshime në prioritetet qeveritare gjithashtu kanë ndikuar në vonesat dhe mosrealizimin e disa projekteve.	Për shkak të kushteve të pafavorshme atmosferike, puna në projektin <i>rehabilitimi i shtratit të lumit në Partesh</i> u ndërpre për disa muaj, duke e bërë të pamundur finalizimin e tij brenda vitit 2024.

Burimi: MZHR

Nga analiza e faktorëve të mësipërm, është e qartë se sfidat në zbatimin e projekteve janë të shumëfishta dhe kërkojnë një qasje të integruar për t'u adresuar në mënyrë efektive. Vonesat në procedurat e prokurimit, pengesat administrative dhe ndikimi i faktorëve të jashtëm kanë ndikuar ndjeshëm në realizimin e investimeve të planifikuara.

Për të përmirësuar ecurinë e tyre në të ardhmen, është i domosdoshëm forcimi i mekanizmave mbikëqyrës dhe rritja e bashkëpunimit ndërinstitutional për të siguruar zbatimin sipas planifikimit. Përsheptimi i procedurave burokratike, menaxhimi më i mirë i fondeve dhe mbikëqyrja e rreptë e progresit të projekteve do të ndihmonin në kapërcimin e këtyre sfidave, duke kontribuar në arritjen e objektivave të Programit për Zhvillim Rajonal.

Projektet dyvjeçare: Përparimi në 2024 dhe bartja për 2025

Në kuadër të Programit për Zhvillim Rajonal, disa projekte janë konceptuar si investime afatgjata, të planifikuara për realizim përgjatë dy viteve 2024 dhe 2025. Nga 27 projektet e përfituara, 14 janë projekte dyvjeçare. Këto nuk klasifikohen si të parealizuara, por si investime të shtrira në kohë, në varësi të kompleksitetit të tyre dhe burimeve të financimit.

Projektet dyvjeçare mund të ndahen në dy kategori kryesore:

- *Projektet që kanë nisur zbatimin në vitin 2024* dhe do të vazhdojnë implementimin në 2025.
- *Projektet që nuk kanë filluar zbatimin në vitin 2024*, për arsye të ndryshme, dhe do të barten për realizim në vitin 2025.

Në vijim, paraqitet analiza e projekteve sipas kategorive të mësipërme.

Projektet që kanë nisur zbatimin në vitin 2024

Si pjesë e Programit për Zhvillim Rajonal, disa projekte dyvjeçare nisën zbatimin në vitin 2024, bazuar në Memorandumet e Mirëkuptimit të nënshkruara ndërmjet MZHR-së dhe komunave përfituese. Këto projekte synojnë të mbështesin zhvillimin ekonomik, përmirësimin e infrastrukturës dhe ngritjen e cilësisë së jetesës. Tabela që pason pasqyron përmbledhjen e financimit për vitin 2024 dhe planin për vitin 2025, sipas rajoneve përkatëse.

Tabela 5: Projektet që kanë nisur zbatimin në vitin 2024

Rajoni zhvillimor / Komuna	Emri i projektit	$\sum$ e aprovuar nga MZHR	$\sum$ e realizuar në 2024	Ndryshimi në 2025
Rajoni Qendër		500,000.00	100,000.00	400,000.00
Podujevë	Ndërtimi i tregut të gjelbërt	500,000.00	100,000.00	400,000.00
Rajoni Veri		190,000.00	120,000.00	70,000.00
Vushtrri	Udha e Gurit	190,000.00	120,000.00	70,000.00
Rajoni Perëndim		530,000.00	193,350.00	336,650.00
Deçan	Turizmi në Deçan	260,000.00	53,350.00	206,650.00
Klinë	Trotuari dhe shtigjet Klinë	270,000.00	140,000.00	130,000.00
Rajoni Juglindje		240,000.00	140,000.00	100,000.00
Shtime	Tregu i hapur Shtime	240,000.00	140,000.00	100,000.00
Rajoni Lindje		270,000.00	150,000.00	120,000.00
Klllokot	Shtrati i lumit Morava	270,000.00	150,000.00	120,000.00
Rajoni Jugperëndim		200,000.00	130,000.00	70,000.00
Rahovec	Ballkoni panoramik	200,000.00	130,000.00	70,000.00
Totali		1,930,000.00	833,350.00	1,096,650.00

Burimi: DPKZHR – MZHR

Siç shihet nga tabela, shumica e projekteve kanë përmbushur fazën e parë të zbatimit në vitin 2024, duke përdorur mjetet e alokuara sipas planit fillestar. Megjithatë, disa projekte kanë pasur ritme të ndryshme të realizimit, gjë që ka ndikuar në nivelin e mjeteve të bartura për vitin 2025. Në vijim, analizojmë më në detaje performancën e projekteve, duke identifikuar sukseset dhe sfidat e hasura gjatë këtij procesi.

Projekti "*Turizmi në Deçan*" është i vetmi që nuk ka arritur të realizojë plotësisht fazën e parë në vitin 2024, duke shpenzuar vetëm 53,350 euro nga 140,000 euro të miratuara për vitin 2024. Kjo nënkupton një realizim prej rreth 38%, duke e bërë atë projektin me përqindjen më të ulët të progresit në këtë grup. Për rrjedhojë, pjesa më e madhe e financimit (86,650 euro apo 62%) bartet për vitin 2025, duke treguar një nevojë të theksuar për përshejtim të zbatimit.

Në të kundërtën, projektet në komunat tjera kanë arritur të implementojnë me sukses fazën e parë. Për shembull, në Podujevë, Vushtrri, Klinë, Shtime, Kllokot dhe Rahovec, financimi i paraparë për vitin 2024 është shpenzuar plotësisht sipas planifikimit. Kjo tregon një ecuri të mirë të zbatimit dhe një koordinim të efektshëm ndërmjet komunave dhe MZHR-së.

Në përgjithësi, përkundër sfidës me projektin në Deçan, pjesa tjetër e projekteve ka dëshmuar një progres të kënaqshëm. Për vitin 2025, vëmendja duhet të përqendrohet tek projektet që kanë nevojë për përshejtim të implementimit, për të shmangur vonesa të mëtejshme dhe për të siguruar përfundimin e suksesshëm të projekteve.


Projektet që barten për realizim në vitin 2025

Në kuadër të Programit për Zhvillim Rajonal, Ministria e Zhvillimit Rajonal (MZHR) kishte planifikuar fillimin e disa projekteve në vitin 2024, në bashkëpunim me komunat përkatëse. Megjithatë, për arsye të ndryshme, një numër i këtyre projekteve nuk kanë mundur të fillojnë zbatimin e tyre sipas planifikimit fillestar, duke u bartur për realizim në vitin 2025. Kjo situatë ka krijuar implikime buxhetore për vitin e ardhshëm, duke ndikuar në menaxhimin e mjeteve të dedikuara për zhvillimin rajonal.

